



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2021:094929

Datë: 21.05.2024

Numri i dokumentit: 05710667

K.DH.SH.II.nr.573/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Franciska Zhitija Ymeri, kryetare e kolegjit, Ramush Bardiqi dhe Krenar Berisha, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Auto Kaçandolli” me seli në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Shoqëria e Avokatëve “SCRL Partners” nga Prishtina, kundër të paditurës Dogana e Kosovës (DK) në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e paditësit, ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.488/22 të datës 11.01.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 20.05.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e paditësit “Auto Kaçandolli” me seli në Prishtinë, e datës 06.02.2024, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, KF.nr.488/22 të datës 11.01.2024, **Vërtetohet**.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e ankimuar është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit “Auto Kaçandolli” me seli në Prishtinë ndërsa është lënë në fuqi aktvendimi nr.01.3.2.2/729 i datës 25.03.2021 i Doganës së Kosovës në Prishtinë. Ndërsa Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ankesë ka paditësit përmes të autorizuarit të tij, për shkak të shkeljes së dispozitave të Kodit Doganor, vërtetimit të gabuar të gjendjes faktike, aplikimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovet si e bazuar ankesa e paditësit “Auto Kaçandolli” me seli në Prishtinë, me NUI 810532376 ushtruar ndaj aktgjykimit të Gjykatës Komerciale Prishtinë Dhomat e Shkallës së Parë KF.nr.488/22 të datës 11.01.2024, të anulohet si i pa bazuar aktgjykimi i Gjykatës Komerciale Prishtinë Dhomat e Shkallës së Parë KF.nr.488/22 të datës 11.01.2024, sipas të cilit aktgjykim është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit dhe është lënë në fuqi aktvendimi i Doganës së Kosovës 01.3.2.2/729 datë 25.03.2021, sipas të cilit aktvendim është refuzuar si e pa bazuar kërkesa e paditësit për rishqyrtimin e vendimeve kontestuese dhe të kthehet lënda përsëri në rishqyrtim dhe rivendosje pranë Gjykatës së Shkallës së Parë.

Përgjigje në ankesë ka paraqitë e paditura me të cilën ka kërkuar që të refuzohet ankesa e paditësit si e pa bazuar.

Gjykata Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerësoi ligjshmërinë e aktgjykimit të kontestuar si në vështrim të nenit 49 të LKA, nenit 81.h të Ligjit për Ndryshimet dhe Plotësimet e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurën nr.03/L-222 dhe nenit 194 i LPK-së, ligj i zbatueshëm sipas nenit 63 të LKA në drejtim të theksimeve në ankesë dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave tjera të lëndës gjen se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se me aktvendimin e organit të paditur nr. 01.3.2.2/729 të datës 25.03.2021, është refuzuar si e pabazuar kërkesa e subjektit në procedurë “Auto Kaçandolli” Shpk-Prishtinë me numër unik identifikues 810532376 për rishqyrtimin e vendimeve R-18932/17.12.2020, R-18935/17.12.2020, R-18936/17.12.2020 të ZBD

Merdare. Dhe janë lënë në fuqi vendimet R-18932/17.12.2020, R-18935/17.12.2020, R-18936/17.12.2020 të ZBD Merdare.

I pakënaqur me aktvendimin e të paditurit subjekti-tani paditësi, ushtron padi në procedurë të konfliktit administrativ në gjykatë. Gjykata Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti Fiskal në këtë çështje, mbanë seancë të shqyrtimit kryesor më datë 11.01.2024, në prani të përfaqësuesve të autorizuar të palëve ndërgjyqëse dhe pas administrimit të provave dhe vërtetimit të gjendjes faktike, gjatë vlerësimit të ligjshmërisë së aktvendimit të organit të paditur, merr aktgjykimin e ankimuar, me të cilin e refuzon kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, ndërsa e lënë në fuqi aktvendimin e organit të paditur, me arsyetim se: gjykata e ka pranuar si të bazuar arsyetimin e vendimit kontestues të paditurës, për arsye se paditësi nuk ka arritur të argumentoj me prova konkrete një gjendje tjetër faktike nga ajo që është vërtetuar nga e paditura me vendimin kontestues dhe se dëshmitë e parashtruara nga paditësi nuk kanë ndikim në vendosje ndryshe në këtë çështje administrative. Gjykata vlerëson se nuk qëndron pretendimi i paditësit se e paditura ka bërë vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike për arsye se nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi as në procedurë administrative tek e paditura po as në kontest tregtar administrativ, gjykatës nuk i ka paraqitur ndonjë dëshmi për të vërtetuar veprimin e Doganës së Kosovës në raport me deklaratat unike doganore R-18932/17.12.2020, R-18935/17.12.2020, R-18936/17.12.2020 për të ndryshuar apo ri klasifikuar mallin ndryshe nga ajo që vetë paditësi e ka deklaruar në rubrikën nr.33 të DUD-ve kontestues, tutje edhe përkundër kësaj pala paditëse nuk ka ndonjë dëshmi apo “informatën tarifore detyruese nga Dogana e Kosovës, nga BE-ja, shteti eksportues dhe apo prodhues me periudhë të vlefshmërisë për periudhën që i referohen DUD-at kontestues”, për të mbështetur kodin tarifor të pretenduar, fakt ky i konfirmuar edhe nga përfaqësuesja e palës paditëse si në seancën e datës 11.01.2023. Gjykata vlerëson se paditësi përveç që nuk ka asgjë kontestuese në deklaratat unike doganore R-18932/17.12.2020, R-18935/17.12.2020, R-18936/17.12.2020, i njëjti nuk ka ofruar as provat relevante informatën detyruese tarifore nga vendi i destinimit apo vendi eksportues i origjinës së mallit të vlefshme për periudhën për Deklaratat Doganore Kontestuese, për të vërtetuar pretendimin se vërtetë malli lëndor klasifikohet në kodin tarifor të pretenduar, edhe pse ky kod tarifor i pretenduar i palës paditëse nuk ndryshon nga ai i deklaruar në DUD-at kontestues si më lart. Sipas nenit 24 par.1 të KDA-së është paraparë që “Detyrimet e importit për tu paguar ligjërisht kur lind një borxh doganor, bazohen në nomenklaturën e mallrave TARIK-ut Tarifës Doganore të Kosovës, ligjeve të zbatueshme në Kosovës dhe çdo marrëveshje me një vend tjetër apo grup vendesh ku hyn edhe

Kosova kur merren masa për lejimin e trajtimit preferencial tarifor”. Në kuptim të dispozitave ligjore, gjykata vlerëson se e paditura ka vepruar drejtë kur mallin e deklaruar nga pala paditëse përmes nr. 01.3.2.2/729 i datës 25.03.2021 e ka proceduar tutje duke mos bërë asnjë ndryshim pra ka pranuar kodet tarifore të deklaruara nga vet paditësi. Gjykata konsideron se vendimi i kontestuar është i qartë dhe i kuptueshëm dhe përmban arsyet e mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë duke vlerësuar se edhe e drejta materiale është zbatuar drejtë. Prandaj në bazë të gjendjes faktike, shkresave të lëndës dhe administrimit të provave, gjykata konstaton se vendimi i Doganës së Kosovës në Prishtinë nr. 01.3.2.2/729 i datës 25.03.2021 është plotësisht i drejtë dhe i bazuar në dispozitat ligjore në fuqi.

Qëndrimin juridik të Dhomës së Shkallës së Parë si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e aprovon edhe kjo gjykatë. Aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Kodit doganor dhe LPA, siç pretendohet në ankesë dhe as me shkelje të tjera të dispozitave të LKA dhe LPK-së, të cilat kolegji i vlerëson sipas detyrës zyrtare, si në vështrim të nenit 194 të LPK-së. Kolegji vlerëson se Dhoma e Shkallës së Parë ka vlerësuar drejtë ligjshmërinë e aktit përfundimtar aktvendimit të Doganës së Kosovës, nr. 01.3.2.2/729 të datës 25.03.2021 të ankimuar nga paditësi.

Kolegji i gjykatës Komerciale-Dhoma e Shkallës së Dytë, e miraton si të drejtë dhe ligjor, aktgjykimin e Dhomës së Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal sepse, nga dëshmitë e administruara ka konstatuar drejtë gjendjen faktike të çështjes në shqyrtim. Gjithashtu, kolegji vlerëson se Organi administrativ e në rastin konkret Dogana e Kosovës, ka konfirmuar vendimet DUD-at R-18932/17.12.2020, R-18935/17.12.2020, R-18936/17.12.2020 të ZBD Merdare, pasi që Sektori i Tarifës ka dhënë sqarim lidhur e mallin lëndor të deklaruar nga subjekti në procedurë ku kanë konstatuar se malli duhet të klasifikohet në kodin 87019290 duke mos bërë ndryshime në kodin tarifor të deklaruar nga paditësi i cili në këtë rast është obliguar të paguaj taksat doganore, andaj kolegji ka vlerësuar se e paditura mbi bazën e dispozitave ligjore e ka ngarkuar paditësin me obligime shtesë doganore.

Kolegji, shqyrtoi edhe pretendimet ankimore të paditësit se paditësi nuk ka deklaruar mallin sipas numrit tarifor i cili është cekur në dokumentacion, por në këtë rast meqenëse ndryshimi i numrit tarifor ka sjellë subjektin në procedurë pagese të taksë së TVSH-së, e paditura Dogana e Kosovës nuk e ka kundërshtuar këtë veprim të subjektit. Në rastin konkret paditësi e ka

ndryshuar numrin tarifor duke mos e deklaruar numrin e saktë siç është cekur në dokumentacionin përcjellës të mallit dhe e paditura nuk e ka dënuar paditësin për kundërvajtje doganore. Kolegji këto pretendime i refuzon si të pa bazuara dhe pa ndikim për vendosjen ndryshe të çështjes, sepse nuk dëshmohet se gabimisht është vërtetuar gjendja faktike e çështjes e cila është vërtetuar në mënyrë të plotë nga Dhoma e Shkallës së parë dhe në organin përfundimtar të Doganës së Kosovës. Kolegji vlerëson se ka qenë obligim i palës që të bëjë deklarinimin e mallit në kodin tarifor sipas dokumentacionit përcjellës dhe më pas të ofroj prova në rast të kontestimit të këtij mallit të deklaruar, paditësi në këtë rast është dashur që të dëshmojë me prova konkrete siç është në këtë rast informata tarifore detyruese e shtetit eksportues, për të dëshmuar kodin e saktë tarifor të mallit lëndor kontestues. Sa i përket pretendimeve ankimore se Gjykata Komerciale, Dhomat e Shkallës së Parë gabimisht ka konstatuar gjendjen faktike, pasi që gjykata nuk ka vlerësuar se paditësi deklarinimin e mallit e ka bërë në kundërshtim me dokumentacionin e mallit me qëllim të evitimit të shpalljes si kryerës të kundërvajtjes doganore. Këto pretendime ankimore kolegji i kësaj gjykate nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, si dhe janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Ngase kolegji pasi ka vlerësuar shkresat e lëndës dhe pas vlerësimit të dokumenteve përcjellëse të mallit nuk ka gjetur prova të cilat do të ndryshonin një gjendje tjetër faktike nga gjendja e konstatuar nga Dhoma e Shkallës së Parë. Prandaj kolegji ka vlerësuar Dhoma e Shkallës së Parë drejtë ka vepruar konform dispozitave të nenit 46 paragrafi 1 dhe 2 të LKA-së, pasi që provat e prezantuara nga paditësi nuk paraqesin dëshmi për të provuar të kundërtën e konstatimit nga e paditura në vendimin kontestues.

Nga tërë kjo që u cek më lartë dhe mbi këtë gjendje faktike, kjo gjykatë konsideron se gjendja faktike është vërtetuar drejtë dhe në mënyrë të plotë, ngase nuk është cenuar ligji në dëm të paditësit. Prandaj, pretendimet ankimore në ankesë se Dhoma e Shkallës së Parë gabimisht ka aplikuar edhe të drejtën materiale në dëm të paditësit, ky kolegji nuk i aprovoi, sepse vlerësoi se të njëjtat janë të paqëndrueshme dhe të pa bazuara për tu aprovuar ankesa, dhe se janë të pa ndikim në vërtetimin e një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar edhe nga Dhoma e Shkallës së Parë. Sepse, aktgjykimi i ankimuar i Dhomës së Shkallës së Parë-Departamenti Fiskal, është i qartë dhe i kuptueshëm si dhe përmban arsye të mjaftueshme për faktet vendimtare, të cilat i pranon edhe kjo gjykatë, andaj, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm. Duke marrë parasysh se Dhoma e Shkallës së Parë, në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale, me rastin kur ka lënë

në fuqi aktvendimin e të paditurës, e pasi që me pretendimet tjera ankimore të përsëritura, të njëpasnjëshme, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 49 të LKA-së, lidhur me nenin 200 të LPK-së, të aplikueshëm sipas nenit 63 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS- Dhoma e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.573/24, me datë 20.05.2024

Kryetare e kolegjit,
Franciska Zhitija Ymeri

Numri i lëndës: 2021:094929
Datë: 21.05.2024
Numri i dokumentit: 05710667